



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 08.05.2023

Nr: 85

Ora: 15:10

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE NR. 19 DHE NR. 20, DATË 06.05.2023 TË KOMISIONERIT
SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 08.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvin	LAKO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

PALË E INTERESUAR:

Qendra "Qëndresa Qytetare", përfaqësuar nga z. Dhimitër Zguro dhe z. Rigels Xhemollari

OBJEKT:

Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj z. Safet Gjici, kryetar i bashkisë Kukës; ndaj z. Betim Lushi, drejtor i shkollës 9 vjeçare "Isuf

Seferi”; ndaj z. Rustem Dervishi, drejtor i shkollës 9 vjeçare “Shaban Murati”, si dhe ndaj zj. Dallëndyshe Bici, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për shkelje të nenit 91 të Kodit Zgjedhor.

BAZË LIGJORE:

Neni 19, pika 1, shkronja “c” dhe neni 21, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë denoncime për përdorim të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore, në lidhje me veprimtari publike në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator *“Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”*.
2. Mbi këtë bazë, Komisioneri ka nisur hetimin administrativ. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri ka vënë në lëvizje KAS-in me anë të dy kërkesave, duke kërkuar marrjen e masës administrative me gjobë ndaj z. Safet Gjici, kryetar i bashkisë Kukës në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë; ndaj z. Betim Lushi, drejtor i shkollës 9 vjeçare “Isuf Seferi” si dhe ndaj z. Rustem Dervishi, drejtor i shkollës 9 vjeçare “Shaban Murati” në masën 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë.

3. Në seancën e datës 08.05.2023, në orën 12:50, me vendimin nr. 79, KAS vendosi shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 19 dhe nr. 20 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në datën 08.05.2023, në orën 15:10.
4. Seanca e datës 08.05.2023 u zhvillua me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, si përfaqësues i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të specialistëve të administratës së KQZ-së. Të pranishëm gjithashtu ishin përfaqësuesit e palës së interesuar Qendra “Qëndresa Qytetare”.
5. Gjatë seancës publike të shqyrtimit pranë KAS, përfaqësuesit e palës së interesuar Qendra “Qëndresa Qytetare” kërkuan shtimin e objektit të kërkesës, duke kërkuar vendosje sanksioni administrativ ndaj zj. Dallëndyshe Bici, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për shkelje të nenit 91 të Kodit Zgjedhor si dhe ndaj subjektit zgjedhor ‘Partia Socialiste e Shqipërisë’, *“si subjekt përfitues / avantazheve të padrejta nëpërmjet përdorimit të burimeve publike”*
6. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
 - Kërkesën nr. 19, datë 06.05.2023 të Komisionerit;
 - Kërkesën nr. 20, datë 06.05.2023 të Komisionerit
 - Kallëzimin e palës së interesuar Qendra “Qëndresa Qytetare” me nr. 3946/1 prot., datë 19.04.2023

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstatoi:

1. Veprimtaritë e denoncuar me anën e denoncimeve nr. **335 ID** dhe nr. **336 ID** janë veprimtari publike të zhvilluara në kuadër të fushatës zgjedhore të kandidatit për kryetar bashkie në bashkinë Kukës, z. Safet Gjici, i cili është aktualisht kryetari në detyrë i kësaj bashkie. Të dyja

veprimtaritë i përkasin të njëjtës tipologji. Ato janë takime elektorale me zgjedhësit e dy njësive administrative të bashkisë dhe janë zhvilluar në mjediset e jashtme të dy shkollave, të shkollës 9-vjeçare "Isuf Seferi", në fshatin Fshat, të Njesisë Administrative Grykë-Çajë, si dhe të shkollës 9-vjeçare, Lusën, Ujmisht. Të dyja veprimtaritë janë zhvilluar në datën 16.04.2023, brenda periudhës së fushatës zgjedhore. Sipas denoncimit, z. Gjici ka qenë i shoqëruar në këto veprimtari nga znj. Dallëndyshe Bici që ushtron detyrën e Drejtores së Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

2. Hetimi administrativ i Komisionerit kishte provuar *"se kryetari i bashkisë Kukës, njëkohësisht kandidat për kryetar në bashkinë Kukës, me zhvillimin e fushatës elektorale në ambientet e shkollës 9-vjeçare Lusën ... (dhe në ambientet e shkollës 9-vjeçare "Isuf Seferi")... ka përdorur burime publike në mbështetje të fushatës së tij zgjedhore"*. Sipas deklarimeve në seancë të përfaqësuesve të administratës së KQZ-së, hetimi kishte provuar se drejtorët e të dy shkollave kishin pasur dijeni për zhvillimin e këtyre veprimtarive elektorale. Komisioneri kishte konstatuar se *"nga hetimi administrativ i kryer dhe nga provat materiale të administruara në dosjen hetimore administrative, vlerësoj se jemi në kundërshtim me nenin 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor, për drejtorin e shkollës 9-vjeçare "Isuf Seferi" fshati Fshat, Kukës, z. Betim Lushi ... (dhe për drejtorin e shkollës 9-vjeçare "Shaban Murati" z. Rustem Dervishi), ... pasi ka vënë në dispozicion të kandidatit për kryetar bashkie, ambientet e shkollës për qëllime zgjedhore"*.
3. KAS-i e gjen të plotë dhe ezaurues hetimin e fakteve nga ana e Komisionerit, si dhe konstaton se kërkesa për marrjen e masës administrative për drejtorin e shkollës 9-vjeçare "Shaban Murati", z. Rustem Dervishi dhe për drejtorin e shkollës 9-vjeçare "Isuf Seferi", z. Betim Lushi, referuar pikës 2, të nenit 171, të Kodit Zgjedhor që parashikon se *"Shkeljet e tjera të dispozitave të këtij Kodi, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen me gjobë nga 1,000 deri në 2,500 lekë"* është e saktë dhe e mbështetur në ligj.
4. Sikurse ka konstatuar edhe Komisioneri, z. Safet Gjici ka marrë pjesë në këto veprimtari në cilësinë e tij si kandidat për kryetar bashkie për bashkinë Kukës. Kodi Zgjedhor, në pikën 20 të

nenit 2 përcakton se *”subjekte zgjedhore” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe KANDIDATËT PËR KRYETARË TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE, të regjistruar në përputhje me këtë Kod*”. Kjo do të thotë, se në trajtimin e shkeljes së konstatuar, Komisioneri ka qenë i detyruar ta trajtonte kandidatin në cilësinë e tij si **SUBJEKT ZGJEDHOR** dhe jo si kryetar bashkie në detyrë. Komisioneri ka bërë referimin e gabuar ligjor, kur ka kërkuar që ndaj kandidatit për kryetar bashkie, z. Safet Gjici të merret masë administrative *”referuar nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, ”Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar ku parashikohet se “shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën veprë penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë”*.

5. Pika 1 e nenit 172 të Kodit Zgjedhor përcakton se *”subjektet zgjedhore kryejnë kundërvajtje administrative në rastet kur në favor të tyre kryhen shkelje të ndalimeve të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji dhe subjektet zgjedhore, pas marrjes dijani, nuk marrin masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes*”. Kandidati për kryetar bashkie, z. Gjici ka qenë në dijani të zhvillimit të veprimtarive në oborret e shkollave. Ato veprimtari organizoheshin për të, me të ose nga vetë ai. Në secilën nga këto rrethana ai ka pasur detyrimin për ndërprerjen e menjëhershme të shkeljes, gjë që nuk ka ndodhur. Në kushtet kur ai ka qenë në cilësinë e subjektit zgjedhor si kandidat për kryetar bashkie i Bashkisë Kukës në këto aktivitete, është e qartë se aktivitetet në shkelje të ndalimeve në K.Zgjedhor, janë kryer në favor të tij.
6. Nuk mund të bëhet i njëjti arsyetim për subjektin zgjedhor “Partia Socialiste” që mbështet kandidatin Gjici. Gjatë shqyrtimit të kërkesës në KAS, si përfaqësuesit e administratës, po ashtu dhe ata të palës së interesuar nuk sollën prova për të vërtetuar faktin nëse Partia Socialiste ka qenë apo jo në dijani të zhvillimit të këtyre aktiviteteve në kushtet e ndalimit nga K.Zgjedhor, ose që personalitete drejtuese të saj të kenë marrë pjesë në këto veprimtari. Prania e znj. Dallëndyshe Bici, Drejtore e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nuk implikon Partinë Socialiste, sepse znj. Bici është zyrtare e lartë e ekzekutivit, por jo funksionare partie. Edhe

nga fjalimet e saj në të dy aktivitetet ajo nuk i referohet asnjëherë prezencës si saj si përfaqësuese e Partisë Socialiste.

7. Nga pozicioni i saj zyrtar, zj. Bici ka patur detyrimin, sipas pikës 2 të nenit 3 të vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020, që të mos merrte pjesë dhe të mos kontribuonte në çfarëdolloj forme në këto veprimtari, për shkak se veprimtarisë i ishin vënë në dispozicion asete (mjediset e jashtme të shkollave), në pronësi/administrim të një institucioni arsimor publik, për qëllime zgjedhore.
8. Shkelja e këtij detyrimi ligjor, ishte në bazë të kërkesës së palës së interesuar për marrjen e masës administrative ndaj zj. Bici. Konstatimi i Komisionerit se *“çdo person, pavarësisht postit që mban, si funksionar i partisë ku aderon, mund të jetë pjesëmarrës në aktivitete dhe të shprehë mendimet e veta, apo preferencat politike, gjithmonë pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore”* nuk ka lidhje me rastin në shqyrtim. E drejta e zj. Bici për të marrë pjesë në veprimtari elektorale në kushtet e përshkruara nga Komisioneri nuk mund të çenohet, përveç kufizimit që i ndalon asaj, në cilësinë si titullare e institucionit *“të drejtojnë, të marrë pjesë apo të kontribuojë në çfarëdolloj forme, në veprimtari publike të ndaluara”* sipas vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020.
9. Pika 2 e nenit 3 të vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020 është dispozitë ndaluese që është vendosur rishtazi me vendimin e Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020, por nuk ka referencë korresponduese në ndonjërin nga dispozitat sanksionuese të Kodit Zgjedhor. Referenca për këtë dispozitë nuk mund të jetë pika 1 e nenit 171 të Kodit Zgjedhor, sepse kjo pikë përcakton sanksionin për shkeljet e kryera *“nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga **PERSONA TË NGARKUAR ME DETYRA**, sipas këtij Kodi”*.
10. Personat e ngarkuar me detyra formojnë një listë personash/institucioneve të cilët janë ngarkuar me detyra nominalisht nga Kodi Zgjedhor. Të tillë janë p.sh. vëzhguesit a përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore në KQZ (për etikën e punës e të komunikimit), Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (për dërgimin e të dhënave nga regjistri për ndarjen e zonave të administrimit

zgjedhor, për listën e zgjedhësve etj), zyra e gjendjes civile dhe kryetari i bashkisë (për listën e zgjedhësve), kryetari i bashkisë (për caktimi e qendrave të votimit), Ministri që ka në varësi shërbimin e gjendjes civile (për nxjerrjen e urdhrave për listat dhe zonat e qendrave të votimit) etj.. Fakti se ata dhe detyrat e tyre përcaktohen nga Kodi do të thotë se lista e tyre është e fundme dhe nuk mund të shtohet me ndonjë akt tjetër ligjor ose nënligjor.

11. Funkionarët e listuar në pikën 2 të nenit 3 të vendimit të rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020 nuk bëjnë pjesë në listën e *"personave të ngarkuar me detyra, sipas Kodit"*. Sanksioni për ta nuk mund të vendoset sipas pikës 1 të nenit 171 të Kodit Zgjedhor. Në konkurrimin midis dispozitës së pikës 2 të nenit 171 të Kodit Zgjedhor dhe dispozitës së pikës 2 të nenit 10 të vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020, KAS-i ka pranuar edhe më parë (shih vendimet nr. 45, datë 04.04.2023, nr. 56, datë 11.04.2023 dhe nr. 65, datë 24.04.2023) zbatueshmërinë e dispozitës që vjen nga ligji dhe jo të dispozitës që vjen nga akti normativ i Rregullatorit.
12. Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 *"Për kundërvajtjet administrative"*, në nenin 6 të tij, ka vendosur kufij të cilët nuk lejojnë që shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative të parashikohen me akte nënligjore, sikurse ka përcaktuar në nenin 10 se *"masa e dënimit me gjobë përcaktohet nga ligji, i cili ka parashikuar kundërvajtjen administrative"*. Autorizimi i pikës 5 të nenit 91 të Kodi Zgjedhor, sipas të cilit *"KQZ-ja nxjerr udhëzime të hollësishme për të përcaktuar përdorimin dhe shpërdorimin e burimeve publike"*, nuk mund të përfshijë të drejtën e Komisionit Rregullator për të caktuar me akt nënligjor dënime administrativ me gjobë, në kundërshtim me formulimet e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 *"Për kundërvajtjet administrative"*. Për rrjedhojë dispozita e aplikueshme për sanksionim në rastin e zj. Dallëndyshe Bici mbetet ajo e pikës 2 të nenit 171.
13. Në lidhje me të drejtën e ankimit, sa i përket z. Safet Gjici, duke qenë se ai është dënuar administrativisht në cilësinë e subjektit zgjedhor, në zbatim të nenit 145 pika 1 të K.Zgjedhor që parashikon se *"Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi"*, ai mund ta ushtrojë të drejtën e ankimit pikërisht

duke ju drejtuar Kolegjit Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Duke qenë se ky vendim është marrë në periudhën e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimit për zgjedhje, atëherë ankimi bëhet brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi. Ky qëndrim mbështetet dhe në praktikën e Kolegjit Zgjedhor që e ka pranuar kompetencën për shqyrtimin e dënimeve administrative ndaj subjekteve zgjedhore, më konkretisht në vendimin nr. 3, datë 09.03.2023.

14. Në lidhje me të drejtën e ankimit për subjektet e tjera, z. Betim Lushi, z. Rustem Dervishi dhe zj. Dallëndyshe Bici, duke qenë se nuk janë në cilësinë e subjekteve zgjedhore, ajo mund të ushtrohet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga njoftimi i vendimit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 21, pika 1, shkronja 'dh', të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesave të Komisionerit dhe palës së interesuar.
2. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj z. Safet Gjici, kryetar i bashkisë Kukës, sipas nenit 172, pika 1 të Kodit Zgjedhor, gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë.
3. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zj. Dallëndyshe Bici, z. Rustem Dervishi dhe z. Betim Lushi, sipas nenit 171, pika 2 të Kodit Zgjedhor, gjobë në masën 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Për pikën 2 të dispozitivit, bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të tij.

Për pikën 3 të dispozitivit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, bazuar në pikën 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar”.

U shpall sot më datë 08.05.2023.

Elvin	LAKO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar